


Dhjetë vjet të veprimtarisë së Revistës Kulturore Evropiane "Haemus" në Bukuresht

Numra të pasur të revistës dhe botime me vlera letrare e kulturore

Drejtuesit e revistës "Haemus", duke qenë ambasadorë të kulturës shqiptare në Rumani, në bazë të punës së gjertanishme premtajnë se veprimtarinë e tyre kulturore do ta pasurojnë edhe më tepër qoftë në prezantimet e letërsisë shqipe në Rumani, qoftë të asaj në rumune në gjuhën shqipe etj. Deri tash kjo është paraqitur me disa botime konkrete, qoftë në poezi, prozë, publicistikë, eseistikë etj. Ndërkaq, numri më ri i revistës "Haemus" sjell një denduri materialesh nga fushat e ndryshme të letërsisë e kulturës shqiptare dhe botërore.



RAGIP SYLAJ

E themeluar që në vitin 2006, Shoqëria Kulturore Shqiptare "Haemus", në Bukuresht, është organizatë me të gjitha tiparet e një vatre, ku do të qëndrojë pandërprerë ndezur flaka e shqiptarisë. Sipas presidentit të Shoqërisë Kulturore Shqiptare "Haemus", akademik Kopi Kyçyku, përveç veprimtarive të shumëllojshme me karakter mbarëkombëtar, zgjidhjes praktike të mjaft çështjeve që lidhen me përtëritjen e vazhdueshme të bashkësisë së shqiptarëve të Rumanisë, ruajtjen e identitetit kulturor të shtetasve shqiptarë me origjinë shqiptare dhe të shqiptarëve që punojnë, studiojnë dhe jetojnë në Rumani, qoftë edhe përkohësisht, Shoqëria do të vazhdojë të promovojë kulturat dhe shpirtërimet shqiptare e rumune përmes revistës "Haemus",- numrin i parë i së cilës ka dalë që më 28 nëntor 1998, - si dhe botimeve të tjera etj.

Programi i Shoqërisë përfshin hapa konkrete për integrimin sa më të plotë të kulturës sonë në circuitet evropiane e botërore; njohjen reale të jetës, mendësisë, specifikës etnike dhe kulturore të pakicave dhe grupeve etnike që jetojnë në Rumani, çka do të lehtësojë mirëkuptimin, tolerancën dhe do të mënjanojë shkallë-shkallë tensionet ekzistuese ose ato që mund të shfaqen në varësi nga gjendja shpirtërore e shoqërisë bashkëkohore; shkëmbimin e informacionit kulturor dhe të qytetërimit mbi dhe ndërmjet pakicave dhe grupeve etnike të hapësirës ballkanike dhe eurojuglindore; grumbullimin e të dhënave të panjohura më parë, që lidhen me konfesionet fetare, me historinë dhe qytetërimin ballkanik e të Evropës Juglindore, si dhe themelimin, - në përputhje me një traditë të hershme paqtuese shqiptare, - të një Qendre Evropiane të Drejtimit Kulturor dhe të Parandalimit të Konfliktëve me karakter etnik, fetar e kulturor etj.

Shoqëria e përmendur ka shtëpinë e vet botuese "Librarium Haemus". Nën përkujdesjen e drejtuesve të saj Kopi Kyçyku & Ardian Kyçyku ka vënë tashmë në qarkullim dhe po përgatit një numër të kënaqshëm veprash të fushave të ndryshme, ndër të cilat: Antologjinë e poezisë rumune (në shqip), me pjesë nga krijimtaria e 185 autorëve të rumanishtes. "Glia Albaneză" (Toka shqiptare) rumanisht - Abdullah Zeneli, me mbresa nga qëndrimi në Korçë i vëllezërve kosovarë, në muajt e vështirë të 1999-ës, romane të Ardian-Christian Kyçykut në shqip. Pastaj vijnë: "Urmele unui arhitect" (Gjurmët e një

arkitekti), rumanisht – monografi e Koço Mihos kushtuar arkitektit të shquar evropian Kristo Sotiri; "Un chip al Țării Sfinte" (Një pamje e Tokës së Shenjtë) - libër-intervistë në rumanisht me ambasadorën e Izraelit në Bukuresht Rodika Radian-Gordon; "Parisul în zadar" (Parisi kot) - roman – Bajram Sefaj; "Simfonia vântului" (Simfonia e erës) - Martin Cukalla; "Fereastra unui strigăt" (Dritarja e një britme) – antologji autori në rumanisht e Anton Çefës; "Vibracione të shpirtit shqiptar" - Prof. Akil Mark Koci; "Un mare european - Pater "(Një evropian i madh - Pater) - Zoe Petre; "Soare dificil" (Diell i vështirë) – antologji autori në rumanisht e Ferik Ferrës, por edhe të Arian Lekës, Ali Podrimjes, etj.

Të gjitha këto vepra janë përkthyer në gjuhët përkatëse nga Kopi Kyçyku, si dhe monografitë origjinale të këtij të fundit (në shqip e rumanisht).

Në dhjetëvjetorin e revistës, është përgatitur edhe trenumërsi 4-1-2 (33-34-35) / 2008-2009. Në të në gjuhët rumanisht dhe shqip sillen poezi, prozë, dramë, ese, kritikë letrare, vështrime, vështrime shkencore, intervista me shkrimtar etj. Ndër to përmendim krijimet letrare të Visar Zhitit, Kopi Kyçyikut, Bajram Sefajt, Ledi Shamku-Shkrelit, Anton Çefës, Hiqmet Meçajt, Ferik Ferrës, Ardian Kyçyikut, Jeton Nezirajt, Dhurata Hamzait, Ridvan Dibrës, Mustafë Xhemailit, Gjekë Marinajt, Bedri Myftarit, Ragip Sylajt, Hida Halimit, Albana Beqirit, Naime Beqirajt, Lasgush Poradecit, Mitrush Kutelit, Miroslav Kerlezha, Salvatore Kuazimodos, Dino Buxatit, Luan Starovës, Fazëll Hysni Dagllarxhait, Marin Soreskut etj.

Drejtuesit e revistës, duke qenë ambasadorë të kulturës shqiptare në Rumani, në bazë të punës së gjertanishme premtojnë se veprimtarinë e tyre kulturore do ta pasurojnë edhe më tepër qoftë në prezantimet e letërsisë shqipe në Rumani, qoftë të asaj rumune në gjuhën shqipe etj.

Kopi Kyçyku & Ardian Kyçyku (drejtuesit e "Haemus") janë emra të njohur dhe të shquar të kulturës sonë. I pari si përkthyes, shkrimtar dhe studiues i fushave të ndryshme, ndërsa i dyti një shkrimtar prodhimtar dhe i veçantë dhe shumë i njohur me romanit e tij që kanë pasur jehonën e tyre si në botën shqiptare, rumune e më gjerë.

Prishtinë, janar 2009